



TABELA E VLERESIMIT TE RISKUT DHE REKOMANDIMET PER DEPISTIM



RISKU RELATIV (RR)	DEPISTIMI I REKOMANDUAR
I Risk mesatar (RR=1)	Rekomandimi
Gra pa asnjë nga faktorët risk të mëposhtëm	Ekzaminim klinik i gjirit çdo tre vjet për gratë 20-40 vjeç dhe çdo vit për ato mbi 40 vjeç Mamografi çdo dy vjet duke filluar nga moshë 50 vjeç
II Risk pak i rritur (RR 1.1 – 3)	Rekomandimi
1 HISTORIA KLINIKE • Lezione joproliferative • Lezione proliferative pa atipi	• Ekzaminim klinik i gjirit si më sipër • Konsidero fillimin e mamografisë që në moshën 40 vjeç dhe përsëritje çdo vit.
2 FAKTORE TE LIDHUR ME RIPRODHIMIN • Menarka para 12 vjeç • Menopauza pas 55 vjeç • Terapi zëvendësuese me hormone të kombinuar (shih më sipër) për të paktën 2 deri 5 vjet (përdorim i tanishëm ose recent) • Nulipare ose lindja e parë mbi 30 vjeç	
3 HISTORIA FAMILJARE • Një i afërm i rendit të parë (nënë, motër, vajzë) me kancer gjiri (pas moshës 50 vjeç).	
4 FAKTORE TE TJERE RISK • Dy deri në pesë pije alkoolike në ditë • Obezitet sidomos pas menopauzës	
III Rritje e forte e riskut relativ (RR I barabarte ose mbi 3)	Rekomandimi
1 Historia klinike • Histori personale kanceri gjiri (invaziv ose DCIS) • Lobular Karcinoma in situ (LCIS) • Hiperplazi atipike lobulare apo duktalet (ADH ose ALH)	• Ekzaminim klinik i gjirit çdo vit • Mamografi çdo vit pas diagnozës
2 Faktorë të tjerë klinikë • Rrezatim terapeutik i gjoksit para moshës 30 vjeç (për sëmundje Hodgkin etj.) • Densitet i lartë i gjirit (mbi 70%) i parë në mamogram	• Ekzaminim klinik i gjirit çdo vit • Mamografi çdo vit (në asnjë rast jo para moshës 25) • Konsultë me specialistin e gjirit
3 Histori familjare • Familjar me kancer gjiri nën moshën 50 vjeç • Dy ose më shumë familjarë të së njëjtës degë me kancer gjiri.	• Ekzaminim klinik të gjirit të paktën çdo vit • Mamografi çdo vit duke filluar që 40 vjeç ose 5 deri 10 vjet më parë se fillimi i kancerit tek familjarët (në asnjë rast jo para moshës 25) • Konsultë me specialistin e gjirit
4 Faktorë gjenetikë • Bartës i njohur ose familjar i rendit të parë me një bartës të defektit BRCA1 apo BRCA 2	
Tregues të tjerë për vlerësim gjenetik të riskut të kancerit • Histori personale e kancerit të gjirit nën moshën 45 ose kancer gjiri në një apo më shumë familiare nën moshën 45 vjeç • Histori personale e kancerit të vezoreve ose kancerit primar peritoneal ose kancer vezorësh apo kancer primar peritoneal në familjarë të ngushtë. • Kancer gjiri tek një familjar mashkull • Kancer gjiri në dy ose më shumë familjarë të dy diagnostikuar para moshës 50 vjeç • Kancer gjiri në tre ose më shumë familjarë të çdo moshe • Kancer gjiri dhe kancer vezorësh në të njëjtin familjar ose në dy ose më shumë familjarë të ngushtë Hasje e kancerit të gjirit së bashku me kancerin e tiroideve kancerin endometrial, kancerin e kockave, sarkomen, karcinomën adrenokortikale, kancerin e trurit, kancerin e stomakut, leucemia akute me fillim të hershëm, të gjitha në të njëjtën degë familjare	• Ekzaminim klinik të gjirit cdo gjashte muaj • Mamografi dhe/ose rezonance magnetike çdo vit nga 25 vjeç • Konsulte me specialistin e gjirit dhe specialistin gjenetik



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK



MALTESER



IAEA